



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

Nr. 1760 prot.

Fushë-Arrëz, më 31. 05.2024

VENDIM

Nr. 24, datë 29.05.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 33, DATË. 29.12.2023 “PËR MIRATIMIN E
PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2024 TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ”**

Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e tij të datë 29.05.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar; neni 1 germa ‘c’ ligji nr.68/2017 ‘Për financat vendore’; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; pika 4.1 e udhëzimit nr.8885, datë 07.11.2016 “Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik” të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes dhe Ministris së Transportit dhe Infrastrukturës; VKB nr.33 datë 29.12.2023 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2024 të Bashkisë Fushë-Arrëz”; paraqet ndryshimet në paketën fiskale.

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në VKB nr.33, datë 29.12.2023 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2024 të Bashkisë Fushë-Arrëz”:

Heqjen e tarifave për shërbimet “Autorizim i përkohshëm një mujor me vlerë 2000 Lekë/autorizim” Kapitulli II, paragrafi 2.5. “Tarifa e shërbimit në fushën e transportit”, Tabela 19,

2. Të miratojë një ndryshim në VKB nr.33, datë 29.12.2024 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2024 të Bashkisë Fushë-Arrëz”:

Shtim “Tarifa për librin e udhëtimit për shërbime turistike”, me vlerë 5000 Lekë Kapitulli II, paragrafi 2.5. “Tarifa e shërbimit në fushën e transportit”.

“Libri i udhëtimit për shërbimet turistike/të rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr. fletëve/nr. udhëtimeve 25)”, sipas tabelës nr. 19 “Tarifat e licensimit të veprimtarive të transportit”, bashkalidhur këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Tatim-Taksave dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

4. Ky vendim u miratua me **8 vota pro.**

Vota Kundër **0 vota**

Vota Abstenim **0 vota**

Ky vendim u shpall me datë **31.05.2024**

SEKRETAR I KËSHLLIT

Tom CURRI

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

